



Green & Just Transition

PËRDITËSIM MBI ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË GJELBËR EVROPIANE NË SHQIPËRI

Autor: Dr. Rodion GJOKA

SHTATOR 2024

Copyright ASP 2022

Akademia e Studimeve Politike

Rruga "Emin Duraku", Pallati Credins Hyrja 1, kati 7, Ap. 21, Tiranë,

Tel: +355 4 5629047, E-mail: info@asp.al, Web: www.asp.al



PËRMBLEDHJE

Ky dokument ofron një përmbledhje të detyrimeve dhe arritjeve të Agjendës së Gjelbër për Shqipërinë, duke e krahasuar me situatën e vitit 2019. Arritja e objektivave të kësaj agjende kërkon përpjekje nga të gjitha sektorët, ku politika luan një rol vendimtar për sigurimin e një vendi konkurrues, të gjelbër dhe të drejtë. Dokumenti vlerëson ndërveprimet midis autoriteteve, organizatave civile dhe partnerëve ndërkombëtarë në zbatimin e politikave për tranzicionin e gjelbër.

Marrëveshja e Gjelbër Evropiane, prezantuar në vitin 2019, synon të bëjë Evropën klimatikisht neutrale deri në vitin 2050. Kjo strategji ka për qëllim përmirësimin e shëndetit publik dhe reduktimin e ndotjes nëpërmjet energjisë së pastër dhe zgjidhjeve të qëndrueshme për industrinë, transportin dhe banimin. Shqipëria, si pjesë e Ballkanit Perëndimor, është një nga rajonet më të prekura nga ndryshimet klimatike dhe përballlet me sfida të mëdha në këtë aspekt.

Në këtë kontekst, BE-ja ka krijuar Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, e cila synon neutralitetin klimatik për rajonin deri në vitin 2050. Shqipëria, së bashku me vendet e tjera të Ballkanit, ka nënshkruar Deklaratën e Sofjes në vitin 2020, duke premtuar uljen e emetimeve të gazeve serrë me 55% deri në vitin 2030.

Dokumentu thekson se përparimi në Shqipëri për tranzicionin e gjelbër është i ngadaltë dhe shpesh i pamjaftueshëm, me përpjekje të kufizuara për përafrimin e politikave dhe zbatimin praktik të tyre. Ligjet dhe nënligjet që synojnë përputhjen me standardet e BE-së në fushën e mjedisit mbeten të pazbatuara në nivel lokal. Politikat për promovimin e energjive të rinovueshme, reduktimin e emetimeve të gazeve serrë dhe përmirësimin e efikasitetit të energjisë kërkojnë më shumë përkushtim dhe koordinim.

Në kuadër të këtij vlerësimi, janë identifikuar rreth 42 politika, nisma ligjore, strategji dhe/ose plane veprimi. Shumica e këtyre politikave zbatohen nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në nivel kombëtar. Vetëm rreth 1/4 e tyre implementohen në nivel lokal. Duhet theksuar se ky vlerësim përfshin vetëm ato iniciativa që qartazi tregojnë një angazhim konkret në përmbushjen e objektivave që rrjedhin nga Deklarata e Sofjes.

Nismat politike për tranzicionin e gjelbër në Shqipëri, në shumicën e rasteve, mbeten sipërfaqësore, duke vendosur objektiva apo strategji sektoriale pa shoqëruar ato me vlerësime ose udhëzime praktike për zbatim konkret në kontekstin lokal. Madje, edhe pas 5 vitesh, nuk ekziston ende një vlerësim qoftë edhe indikativ mbi ndikimin social, ekonomik apo kulturor që pritet të sjellë tranzicioni i gjelbër në Shqipëri.

POTENCIALI I AGJENDËS SË GJELBËR DHE TRANZICIONI GJELBËR

Tranzicionet gjelbër kërkon përshtatje teknologjike, sociale, kulturore dhe ekonomika. Ndryshime të cilat janë sfida komplekse që kërkojnë adaptim të njohurive ekzistuese, të nxjerra nga përvojat e mëparshme. Shtetet që janë të mirëpërgatitura për këtë transformim do të jenë më të afta për ta përballuar atë, ndërsa sektorët dhe rajonet që varen nga teknologjitë ndotëse dhe burimet konvencionale të energjisë do të përballen me rënie të ndjeshme të ekonomisë përpara se të njohin një stabilitet e rritje të saj. Këto rajone do të kenë nevojë për mbështetje për të përballuar ndikimet sociale negative dhe për të krijuar mundësi të reja ekonomike. Në të kundërt, disa rajone të tjera do të përjetojnë zhvillim të vrullshëm, duke sjellë sfida të reja për të ruajtur balancën midis zhvillimit ekonomik dhe qëndrueshmërisë mjedisore. Për të qenë i suksesshëm, tranzicioni gjelbër duhet të planifikohet dhe monitorohet me kujdes për të minimizuar kostot ekonomike dhe sociale të tij.

1. Klima, Energjia dhe Mobiliteti (Dekarbonizimi)

Shqipëria, si pjesë e Ballkanit Perëndimor, është një nga rajonet më të rrezikuara nga ndryshimet klimatike, duke e bërë prioritet përafrimin e politikave klimatike me ato të Bashkimit Evropian. Në veçanti, sektori i energjisë dhe transportit duhet të pësojë dekarbonizim për të reduktuar emetimet e gazeve serrë dhe për të rritur qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike. Rreth 55% e popullsisë

shqiptare është e ekspozuar ndaj rreziqeve të lidhura me klimën, një shifër që tejkalon mesataren globale prej 40-45% . Investimet e paqëndrueshme në hidroenergjë kanë rezultuar në përkeqësimin e burimeve ujore dhe mungesën e përmbushjes së kërkesës energjetike .

Pavarësisht nga kapaciteti hidroenergjetik i instaluar, Shqipëria mbetet vulnerabël për shkak të varësisë nga reshjet e shiut, një problem që është bërë më i theksuar nga ndryshimet klimatike. Si rrjedhojë, diversifikimi i burimeve të rinovueshme si energjia diellore dhe ajo eolike është urgjente për të siguruar një sistem energjetik më të qëndrueshëm dhe për të përmbushur objektivat për neutralitet klimatik .

2. Lëvizja drejt një “ekonomie qarkulluese”

Orientimi drejt një ekonomie qarkulluese është thelbësor për arritjen e tranzicionit të gjelbër, veçanërisht për sektorët që preken drejtpërdrejt nga kjo ndryshim. Në Shqipëri, ky koncept është ende në fazë të hershme dhe përballon sfida të mëdha në aspektin e menaxhimit të mbetjeve . Infrastruktura aktuale e trajtimit të mbetjeve është larg nga standardet evropiane, dhe politikat ekzistuese nuk kanë krijuar ende kushtet për një aplikim të plotë të ekonomisë qarkulluese .

Pavarësisht nga miratimi i disa ligjeve për menaxhimin e mbetjeve dhe strategjitë për uljen e sasisë së tyre, hendeuku midis miratimit dhe zbatimit të këtyre politikave mbetet i madh. Transpozimi i rreth 70% të direktivave evropiane nuk ka prodhuar ende rezultate të prekshme, pasi vetëm 10% e tyre zbatohen realisht në terren (Kumbaro, 2023).

3. Ndotja e ajrit, ujit dhe tokës

Ndotja e ajrit është një nga problemet më të mëdha në Ballkanin Perëndimor, me ndikime të drejtpërdrejta në shëndetin publik dhe ekonominë e rajonit . Shqipëria vuan nga ndotja e lartë e ajrit, që sipas Agjencisë Evropiane të Mjedisit shkakton mbi 2,800 vdekje të parakohshme çdo vit . Po ashtu, ndotja e brendshme nga përdorimi i lëndëve djegëse të ngurta kontribuon në 724 vdekje të parakohshme (European Environmental Agency, 2021). Mungesa e monitorimit të saktë dhe të vazhdueshëm ka krijuar një situatë të rrezikshme për qytetarët dhe mjedisin, duke përkeqësuar konfliktet midis komuniteteve të prekura dhe industrive ndotëse .

Sa është realisht ndikimi në shëndetin publik ndaj ekspozimit të ndotësve në ajër, ujë dhe tokë në Shqipëri?

Ka kaluar një dekadë që nga publikimi i shifrave të fundit nga Instituti i Shëndetit Publik dhe më shumë se 5 vjet që kur Agjencia Kombëtare e Mjedisit raportoi një status të saktë të ndotjes. Mungesa e kapaciteteve monitoruese ka arritur në një nivel të ulët të paprecedentë gjatë viteve 2020-2024.

4. Ndërtimi i sistemeve të qëndrueshme të bujqësisë dhe ushqimit

Bujqësia dhe sektorët e lidhur kontribuojnë në rreth 10% të PBB-së në Ballkanin Perëndimor. Megjithatë, sektori i bujqësisë dhe BPPTT (Bujqësia, Pyjet dhe Përdorimet e Tjera të Tokës) në Shqipëri janë ndër kontribuesit kryesorë të emetimit të gazeve serrë (GES) . Ndryshimet klimatike pritet të ndikojnë ndjeshëm në sektor, duke rritur frekuencën dhe intensitetin e zjarreve, përmytjeve dhe thatësisë, të cilat do të reduktojnë burimet ujore. Ndryshimi i praktikave bujqësore do të jetë i nevojshëm për të ruajtur rendimentin dhe prodhimin ushqimor pa rrezikuar bagëtinë dhe qëllimet për nxitjen e prodhimit bujqësor.

5. Mbrojtja e biodiversitetit dhe ekosistemeve

Ndryshimet klimatike dhe metodat tradicionale të shfrytëzimit të energjisë, përfshirë hidrocentralet, kanë pasoja të rënda për biodiversitetin dhe ekosistemet. Këto ndikime krijojnë kosto të mëdha mjedisore dhe ekonomike, duke shkaktuar shkretim dhe shndërrim të ekosistemeve . Në vitin 2022, u rishikuan kufijtë e disa zonave të mbrojtura, duke u kritikuar nga OSHC-të për fragmentimin e habitatit dhe humbjen e specieve . Një zhvillim pozitiv ishte shpallja e lumit Vjosa si Park Kombëtar, e cila pritej të forcojë mbrojtjen nga zhvillimi i pakontrolluar por rezultatet e deritanishme tregojnë veçse intensifikim të ndërhyrjeve në deltën e Vjosës qoftë me ndërtimin e aeroportit si edhe me planet për resorte turistike.

6. Informimi dhe Konsultimi Publik

Ligji për të drejtën e informimit dhe konsultimin publik është themelor për mbrojtjen dhe menaxhimin mjedisor . Megjithatë, përkundër rritjes së mundësive për konsultime nëpërmjet platformave elektronike, pjesëmarrja e aktorëve të shoqërisë civile mbetet e ulët për shkak të mungesës së besueshmërisë . Kapacitetet e kufizuara të institucioneve për të reaguar ndaj ndotjes ose abuzimeve mjedisore shtojnë më tej sfidat . Mbrojtja e mjedisit kërkon përfshirje aktive të komunitetit dhe shoqërisë civile, duke u siguruar që shqetësimet e tyre të adresohen dhe të përfshihen në vendimmarrje.

Analiza SWOT

Avantazhe	Dobësi
Shqipëria ka potencial të konsiderueshëm në burimet e rinovueshme të energjisë, si energjia hidrike, diellore dhe erës. Vendi ka një popullsi relativisht të re që është gjithnjë e më e vetëdijshme për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit. Shqipëria ka potencial të pashfrytëzuar në eko-turizëm, i cili mund të nxisë ekonominë e vendit dhe të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm. Shqipëria ka një bollëk burimesh natyrore, duke përfshirë pyjet dhe zonat bregdetare, të cilat mund të përdoren në mënyrë të qëndrueshme dhe të përgjegjshme. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe angazhimit të qeverisë për të kaluar drejt një ekonomie të gjelbër. Kuadër e fortë e politikave për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Prania e projekteve të infrastrukturës në shkallë të gjerë si Gazsjellësi Trans-Adriatik (TAP) i cili mund të përdoret potencialisht për transportin e energjisë me karbon të ulët si edhe për të rritur sigurinë energjitike në raste ekstreme. Disponueshmëria e burimeve natyrore si pyjet, lumenjtë dhe liqenet, të cilat mund të ruhen dhe të shfrytëzohen për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.	Mungesa e infrastrukturës dhe investimeve në burimet e rinovueshme të energjisë është një pengesë e madhe për tranzicionin e gjelbër. Vendi ende mbështetet shumë në lëndët djegëse fosile, të cilat jo vetëm janë të dëmshme për mjedisin, por gjithashtu kontribuojnë në ndotjen e ajrit dhe problemet shëndetësore. Mungesa e rregulloreve efektive për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm. Niveli i ulët i edukimit publik mbi tranzicionin e gjelbër. Zbatimi i pamjaftueshëm i politikave që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit. Burime të kufizuara njerëzore dhe financiare për investime në industri dhe teknologji të gjelbër. Mungesa e infrastrukturës adekuate për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë së rinovueshme. Sistemet joadekuate të menaxhimit të mbetjeve që çojnë në ndotje dhe degradim të burimeve natyrore. Objektivat e lidhura me klimën nuk janë ende të institucionalizuara dhe burimet njerëzore sidomos në nivel lokal kanë njohur të limituar lidhur me agjendën e gjelbër dhe mjedisin në tërësi.


Oportunitete	Kërcënime
Agjenda e Gjelbër sikundër edhe ekonomia e karbonit mund të shërbejë si një mundësi ku Shqipëria të përthith fonde dhe mbështetje. Rritja e kërkesës për produkte dhe shërbime miqësore me mjedisin mund të krijojë mundësi të reja potenciale në treg siç është rasti lëndëve djegëse alternative apo bursa e karbonit. Rritja e interesit mbi teknologjinë e gjelbër dhe natyrën tërheq investime madje në zonat më të thella në vend. Turizmi mjedisor mund të gjenerojë të ardhura dhe të krijojë vende pune sezonale apo përgjatë gjithë vitit Potencial për të përmbushur nevojën e brëndshme për energji ne sektorët e industries, banimit dhe transportit nga shfrytëzimi energjisë diellore në tokat e kripura dhe djerrë. Disponueshmëria në rritje e fondeve nga organizatat ndërkombëtare si Bashkimi Evropian dhe Banka Botërore për zhvillimin ekonomik të gjelbër. Mundësia kreditit në mbi 400 mln euro / vit nga tregtimi karbonit dhe gazeve serë.	Mungesa e vullnetit të singert politik dhe e përkushtimit ndaj nismave të gjelbra. Rezistencë e mundshme nga industria e karburanteve fosile dhe interesa të tjera të fuqishme ekonomike në vend. Fatkeqësitë natyrore si përmbytjet dhe rrëshqitjet e dheut, të cilat po bëhen gjithnjë e më të shpeshta për shkak të ndryshimeve klimatike, mund të pengojnë përparimin drejt një tranzicioni të gjelbër. Propaganda e gjelbër - kompanitë dhe organizatat që pretendojnë të jenë miqësore me mjedisin, ndërkohë që ende angazhohen në praktika të dëmshme për mjedisin. Ndikimi i ndryshimeve klimatike që paraqet një kërcënim të madh për mjedisin dhe komunitetet e cënueshme. Kapacitet i kufizuar për t'u përshtatur dhe për të zbutur efektet e ndryshimeve klimatike. Varësia nga importi energjisë që kontribuojnë në pasigurinë energjetike të vendit. Keqmenaxhimi dhe ndotja e tokës, ujërave dhe ajrit. Kostoja e lartë e investimit në infrastrukturën dhe teknologjinë për menaxhimin e mjedisit kërcënon procesin e integritetit në një kohë kur një pjese e investimeve si impiantet e trjtitimit të ujërave dhe incineratorët mbeten jo-funksional edhe pas investimit.

Shqipëria duhet të mbështesë më tutje Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit me një kuadër normativ të përshtatur me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs). Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në shtator 2015 SDG-të përbëhen nga 17 objektiva politike dhe 169 objektiva specifike ku shumica prej tyre janë të mbështetura me tregues të matshëm të performancës kryesore (KPI)

Aktualisht, nga viti 2019 kur u ratifikua agjenda e gjelbër, Shqipëria vlerësohet të ketë bërë një progres të ngadaltë drejt angazhimeve të marra në Marrëveshjen e Sofjes. Rreth 14% në nivel sasi vlerësohet të jetë progresi i cili konsiston vetëm në amendime dhe miratime ligjore, strategji apo paketa rregulloresh nga ana e vëndit tonë, pra rreth 2.8%/vit është ritmi i përafërimit të Shqipërisë me objektivat

e Marrëveshjes së Gjellbër. Për më tepër një përafrim i cili nuk i atribuohet zbatimit të ligjive apo kapaciteteve teknike dhe njerëzore të investuara këto vite në terren.

Vlerësimi progresit 2019 – 2024



REKOMANDIME PËR POLITIKËBËRËSIT

Bazuar në analizën e situatës aktuale dhe detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Gjellbër, ofrohen disa rekomandime konkrete për orientimin e politikave dhe reformave në Shqipëri, të grupuara sipas pesë shtyllave kryesore:

Klima dhe Energjia

Krijimi i një kuadri ligjor për programin “Climate Neutral Albania 2050” për të bashkërenduar Marrëveshjen e Gjellbër dhe Marrëveshjen e Sofjes.

Rishikimi i Masterplanit të Gazit për të shmangur rritjen e emetimeve të CO2 me 28%, në përputhje me objektivat e reduktimit të gazeve serë.

Përfshirja e komuniteteve vulnerabël në diskutimet për ndryshimet klimatike dhe zhvillimi i Planit Kombëtar për Dekarbonizimin brenda vitit 2024.

Transparenca dhe rritja e kapaciteteve lokale për menaxhimin e klimës, si dhe aplikimi i një regjistri të plotë të ndotjes për monitorimin e gazeve serë.

Diversifikimi i burimeve të energjisë me energji të rinovueshme dhe mbështetja e auto-konsumit nga burime të rinovueshme për familjet.

Hartimi i planeve të veprimit për sektorët kyç për dekarbonizim (industria, transporti, bujqësia), si dhe miratimi i planeve të rezilencës dhe reduktimit të riskut klimatik.

Transporti

Diversifikimi i modaliteteve të transportit, përfshirë rrjetet hekurudhore, dhe mbështetja për automjetet elektrike, veçanërisht në qytete me popullsi të dendur.

Zbatimi i strategjive për krijimin e zonave me emetim të ulët dhe elektrifikimi i transportit publik në qytete si Tirana, Durrësi, Vlora, etj.

Ekonomia Qarkulluese

Hartimi i Strategjive Sektoriale për kalimin drejt ekonomisë qarkulluese në industrinë prodhuese, ndërtimtari dhe menaxhimin e mbetjeve deri në vitin 2023.

Zhvillimi i mekanizmave për gjurmimin dhe tregtimin e karbonit për të shmangur pengesa në eksportet europiane.

Ndotja

Forcimi i kapaciteteve të Ministrisë së Mjedisit dhe dedikimi i fondeve për arritjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Cilësinë e Ajrit.

Përmirësimi i infrastrukturës për monitorimin dhe raportimin e ndotësve në ajrin urban, dhe përshtatja e praktikave më të mira industriale për të zvogëluar ndotjen.

Bujqësia e Qëndrueshme

Bashkërendimi i përpjekjeve ndërsektoriale për përmirësimin e efikasitetit bujqësor dhe integrimi i praktikave të qëndrueshme në programet e mbështetjes financiare dhe teknike si IPARD (2021-2027).

Krijimi i një taks-forcë për të monitoruar zbatimin e nismave “Climate Neutral Albania 2050” dhe zhvillimin e politikave klimatike të qëndrueshme deri në vitin 2025.

Këto rekomandime kanë për qëllim të sigurojnë një qasje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për përballimin e sfidave klimatike dhe mjedisore të Shqipërisë, duke përfshirë aktorët kryesorë në vendimmarrje dhe monitorimin e zbatimit të politikave.

Referencat:

European Commission, 2019. The European Green Deal. [Online] [Accessed 15 2 2024].

IPCC Intergovernmental Panel on Climate Change, United Nations, 2021. <https://www.ipcc.ch/>. [Online] Available at: <https://www.ipcc.ch/report/sixth-assessment-report-working-group-i/> [Accessed 16 2 2024].

European Commission, 2020. Green Agenda for the Western Balkans, Brussels: EC.

Regional Cooperation Council, 2020. Sofia Declaration on the Green Agenda for the Western Balkans. [Online] Available at: <https://www.rcc.int/docs/546/sofia-declaration-on-the-green-agenda-for-the-western-balkans-rn> [Accessed 9 February 2024].

European Environmental Agency, 2021. Air Quality in Europe 2021, Copenhagen: EEA.

Regional Cooperation Council, 2021. Action Plan for the Implementation of Sofia Declaration, Brussels: October.

Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit, 2021. Raporti Mushkëri të Gjelbra, Tiranë: Co-PLAN.

Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 2019. [Online] Available at: <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/vkm-412-2019-menaxhimi-i-ajrit.pdf> [Accessed 22 January 2024].

European Commission, 2021. Albania Progress Report, Belgium: EC.

Kumbaro, m., 2023. [Online] Available at: <https://tvklan.al/do-te-jete-permbysje-e-mentalitetit-mirela-kumbaro-shpjegon-pr-liqjin-per-perqiejtesine-e-prodhuesit>

Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, 2021. Raporti i Parë të Dyvjeçar i Përditësuar në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, Korrik 2023